

Menaxhimi i Mbeturinave Mjekësore Në Kosovë



Përmbajtja

1. Hyrje
2. Legjislacioni në fuqi dhe zbatimi në teren
3. Sa e njuh ligjin profesionisti
4. Raportet e inspektoratit mjedisor dhe farmaceutik
5. Gjendja aktuale e mbeturinave mjekësore në Kosovë
6. Kosova krahasuar me shtetet tjera
7. Rekomandimet

Hyrje

Mbeturinat mjekësore-farmaceutike përbëjnë një rrezik më të madh për shëndetin e njeriut në krahasim me llojet tjera të mbeturinave. Ky rrezik vjen si rezultat i materieve të ndryshme helmuese që përmbajnë mbeturinat mjekësore dhe që përbejnë një rrezik jo vetëm për shëndetin e njeriut por edhe për ambientin në tërësi.

Që nga viti 1999 Kosova po kalon një periudhë ndryshimesh të mëdha organizative të sistemit shoqëror në tërësi, e në veçanti të atij shëndetësor-farmaceutik.

Donacionet e barnave, menaxhimi jo i mirë i tyre, lejet speciale, funksionimi i tregut në të zezën ka bërë që në Kosovë të grumbullohet një sasi e madhe e mbeturinave mjekësore me potencial rreziku për shëndetin e njeriut dhe për ambientin në tërësi.

Një sasi e madhe e mbeturinave farmaceutike në pronësi e MSH e cila ka qenë e deponuar Depon e Masgitit (nën menaxhimin e MSH-së) është asgjësuar nga MSH në vitin 2012. Megjithatë një sasi e madhe e mbeturinave farmaceutike mbete e deponuar barnatoret private, depot farmaceutike, klinikat, qendrat e mjekësisë familjare, persona fizik etj. Është brengosës fakti se ende, edhe sot nuk kemi një sistem funksional të menaxhimit të këtyre mbeturinave që paraqesin një rrezik të potencial të lartë për shëndetin dhe mjedisin. Kjo duke pasur parasysh faktin është e pa izoluar dhe e pa menaxhuar prandaj kërkon një vëmendje dhe kujdes të veçantë.

Duke u nisur nga rëndësia e kësaj problematike KADC ka zhvilluar një hulumtim më qëllim të ofrimit të dhënave mbi nevojën e ndërtimit të një sistemi të mirë të menaxhimit të mbeturinave farmaceutike, përfitimet që vijnë nga menaxhimi i mirë dhe ofrimin e praktikave nga rajoni rreth mënyrës së zgjedhjes së këtij problemi.

Të dhënat e paraqitura në këtë punim janë të bazuara në dokumentet e institucioneve kompetente, punimet e ndryshme të përgatitura nga organizata dhe individ të ndryshëm si dhe intervistat e realizuara me individë që janë faktor me ndikim në këtë proces.

Legjislacioni dhe zbatimi në terren

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave mjekësore-farmaceutike në Kosovë është i rregulluar me Ligjin për mbeturina, LPPM, Udhëzimin administrativ 05/2008 për

Administrimin e Mbeturinave dhe Udhëzimin Administrativ 12/2008 për Asgjësimin e Mbeturinave të Produkteve Mjekësore.

Sipas Udhëzimit 12/2008 për Asgjësimin e Mbeturinave të Produkteve Mjekësore, Ministria e Shëndetësisë kryen këto detyra:

- a) Kontrollon dhe mbikëqyr administrimin e mbeturinave të produkteve mjekësore të gjeneruara në institucionet shëndetësore publike dhe në ato private;
- b) Bën evidentimin e institucioneve të cilat krijojnë mbeturina të produkteve mjekësore, përpunimin e shënimeve, publikimin e rregullt dhe ruajtjen e shënimeve;
- c) Bën identifikimin e mbeturinave të produkteve mjekësore dhe vlerëson nëse ato duhet të konsiderohen si produkt mjekësor i përdorshëm apo i papërdorshëm
- d) Udhëzon për mënyrën e shkatërrimit të mbeturinave mjekësore;
- e) Bën klasifikim të mbeturinave sipas llojit, formës, kategorizimit, rrezikshmërisë për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin dhe sipas grupit terapeutik;
- f) MSH bën koordinimin ndërmjet MMPH-se, MBPZHR-se dhe MPB-se, në përcaktimin dhe zbatimin e politikave për administrimin e mbeturinave të produkteve mjekësore dhe veterinarë në Kosovë;
- g) Bën evidentimin, publikimin e rregullt dhe ruajtjen e shënimeve për mbeturinat e produkteve mjekësore duke shënuar: emrin komercial, emrin gjenerik, emrin e prodhuesit, sasinë dhe formën farmaceutike;

Udhëzimi Administrativ për Administrimin me Mbeturina Mjekësore 05/2008, përcakton që:

- h) Mbeturinat e produkteve mjekësore duhet të ruhen në thasë prej najloni me ngjyrë të gjelbër.
- i) Qendrat e Mjekësisë Familjare janë të obliguara që nga qytetarët të pranojnë medikamente me afat të skaduar të përdorimit, ose të dëmtuara duke i vërtetuar ato nga mjeku me recete apo raport.

Sipas Ligjit për Pajisje dhe Produkte Mjekësore barnatoret duhet të pranojnë nga qytetarët barnat me afat të skaduar. Duke u bazuar në ligjet ekzistuese, në terren është vërejtur se në përgjithësi zbatueshmëria e tyre është e vogël dhe se deri më tani, përpos sasisë së asgjësuar në depon e "Mazgitit" nuk është marrë ndonjë iniciativë për hulumtimin e sasive dhe identifikimin e mbeturinave mjekësore/farmaceutike që ndodhen nëpër institucionet tjera që krijojnë mbeturina mjekësore/farmaceutike.

Si rezultat i bashkëpunimit ndër-ministoror deri më tani janë formuar tre (disa) komisione për hartimin e një strategjie për menaxhim të mbeturinave mjekësore. Këto komisione kanë dalë me rekomandimet e tyre të cilat kanë mbetur vetëm në letër dhe asnjëherë nuk është informuar zyrtarisht për sasi të dhe specifikat tjera të mbeturinave mjekësore.

Sa e njëh legjislacionin profesionisti

Në këtë hulumtim kemi marre një mostër prej 100 barnatoreve në gjithë regjionin e Kosovës me fokus kryesor në qytetin e Prishtinës dhe qendrat tjera regjionale. Nga 100 barnatoret e vizituara, 90 prej tyre nuk janë të informuara se kanë obligim ligjor t'i pranojnë medikamentet me afat të skaduar nga ana e pacientëve.

Gjithashtu 84% e barnatoreve nuk janë të informuara se mbeturinat e produkteve mjekësore duhet të ruhen në qese najloni me ngjyrë të gjelbër, dhe as se ku mund t'i sigurojnë këto qese.

Qendrat e Mjekësisë Familjare po ashtu nuk janë të informuara se janë të obliguara me ligj të pranojnë medikamentet me afat të skaduar nga ana e pacientëve.

Raportet e inspektoratit mjedisor dhe farmaceutik

Inspektorati mjedisor ka zhvilluar një numër vizitash nëpër barnatore me qëllim inspektimi se a janë duke i ruajtur në mënyrën e duhur medikamentet me afat të skaduar. Vizitat janë kryer kryesisht nëpër barnatoret e qytetit të Prishtinës dhe në periudhën në mes viteve 2009-2011. Duhet cekur se janë vizituar një numër i vogël i barnatoreve, ndoshta edhe duke pasur parasysh faktin se numri i barnatoreve po shkon çdo ditë në rritje.

Objektivë e inspektimit ishte administrimi me mbeturinat mjekësore-farmaceutike në përputhje me Udhëzimin Administrativ 05/2008 për Administrimin me Mbeturina Mjekësore.

Inspektorati raporton se nga numri i barnatoreve të vizituara, asnjë barnatore nuk i ka pasur barnat e ruajtura në qese të gjelbërta në përputhje me **U.A. 05/2008**, prandaj në këtë drejtim edhe janë dhënë vërejtjet si më poshtë:

- 1) Barnatoret janë udhëzuar se ndalohet deponimi i mbeturinave në depot komunale
- 2) Barnat me afat të skaduar-tashmë mbeturine- të ruhen në vende të veçanta dhe të ruhen deri në zgjidhjen përfundimtare me asgjësim ose të dërgohen në vendet e veçanta për grumbullimin e produkteve mjekësore

Ndërkaq nga ana e Inspektoratit Farmaceutik nuk kemi asnjë raport zyrtar mbi gjendjen e barnave me afat të skaduar. Gjatë takimeve me zyrtar të inspektoratit kemi marrë pohime se janë të klasifikuara një sasi prej tyre por asnjë gjë zyrtare nuk është raportuar.

Gjendja aktuale e mbeturinave farmaceutike

Siç edhe është nënvizuar me sipër gjendja aktuale e mbeturinave mjekësore në vendin tonë dihet vetëm përafërsisht. Në barnatoren qendrore në QKUK është një gjendje solide në administrimin me mbeturina mjekësore për shkak të asgjësimit dhe shpërndarjes sipas rregullës FIFO që është bërë nga menaxhmenti.

QKUK raporton një sasi të vogël të anestetikëve të deponuar me afat të skaduar dhe janë të ndara nga ato me afat të rregullt .

Por duhet cekur se edhe nëpër barnatoret e klinikave ka një sasi të barnave me afat të skaduar të cilat nuk janë të menaxhuara në përputhje me kërkesat ligjore.

Gjetjet në barnatoret private tregojnë se sasia e barnave me afat të skaduar është shumë e madhe.

Siç është cekur më sipër nga raportet e inspektoratit mjedisor, në përgjithësi barnat me afat të skaduar nuk ruhen në vende të veçanta por ato kryesisht gjenden të ruajtura nëpër paketa të ndryshme dhe ndonjëherë edhe bashkë me barnat me afat të rregullt.

Numri më i madh i barnatoreve nuk i kanë të klasifikuara barnat me afat të skaduar dhe nuk kanë njohuri se ku duhet dërguar barnat pa afat.

KADC ka bërë një hulumtim në 100 barnatore nëpër regjionin e Kosovës. Subjekt i hulumtimit kanë qenë barnatoret të cilat kanë qarkullim tregtar të ndryshëm nga ato me

qarkullim të lartë deri te ato me qarkullim të ulët të përqendruara nëpër qendrat më të mëdha të Kosovës si Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjiilan.

Nga 100 barnatoret që i kemi marrë për hulumtim, 19 barnatore kanë regjistruar sasinë e barnave pa afat, barna që janë grumbulluara brenda një viti. Shprehur në vlerë monetare, barnatoret me qarkullim rreth 400 -500euro/ditë raportojnë përafërsisht 10.000 euro vlerë të barnave me afat të skaduar të grumbulluara në 10 vjetët e fundit, dhe të cilat nuk janë të klasifikuara.

Depot farmaceutike- distributor farmaceutik në përgjithësi i kanë të klasifikuara barnat me afat të skaduar dhe disa prej tyre edhe raportojnë.

Shumica prej distributoreve nuk kanë marrëveshje që ti kthejnë produktet që ju ka skaduar afati në kompaninë bazë por ato mbeten si mbeturina në Kosovë të cilat pritet të asgjësohen më pastaj.

Një pjesë e vogël kompanive raportojnë të kenë kanë marrëveshje me prodhuesin për ti dërguar që të asgjësohen në shtetin prej nga vijnë, megjithatë legjislacioni dhe procedurat e tjera e vështirësojnë jashtëzakonisht shumë procesin e kthimit.

Procedurat për kthimin në vendin e origjinës te barnave me afat të skaduar janë të paqarta dhe pothuajse një proces i tillë rezulton të jetë i pamundur. Një kompani austriake që operon në vendin tonë nuk ka marrë përgjigje nga asnjë prej institucioneve relevante lidhur me procedurën e lartpërmendur.

Kosova krahasuar me shtetet tjera

Në kohën e sotme, me zhvillimet e hovshme teknologjike të shoqëruara edhe me prodhimtari të shtuar, rritja e sasisë së mbeturinave në përgjithësi është në rritje e sipër dhe çdo ditë e më tepër po merr një angazhim më serioz në të gjitha vendet e botës.

Gjatë konflikteve dhe katastrofave natyrore sasi të mëdha të barnave janë dhuruar shpesh si ndihma humanitare. Pa dyshim se një sasi e këtyre barnave ka shërbyer për të shpëtuar jetë, lehtësuar vuajtjet, por disa donacione të dhëna për qëllime të mira mund të shkaktojnë edhe probleme. Barnat mund të vijnë me afat të skaduar ose afër afatit të skadimit, mund të jenë të shkruara në gjuhën që nuk e kupton farmacisti dhe të mos përdoren asnjëherë. Gjithashtu mund të jenë të destinuara për patologji që ai regjion fare nuk i ka të shprehura siç ka ndodhur me rastin e Kosovës. Në bazë të disa informacioneve një sasi të konsiderueshme të barnave me afat të skaduar të grumbulluara në të kaluarën kanë qenë donacion dhe kanë pasur si qëllim mjekimin e

Malaries. Duke pasur parasysh se Kosova asnjëherë nuk është shquar si vend malarik e gjithë ajo sasi është shndërruar në mbeturinë.

Historikisht, sistemet e menaxhimit të mbeturinave janë krijuar për të mbrojtur shëndetin publik. Shtetet e ndryshme, administrimin e mbeturinave farmaceutike e kanë të rregulluar me ligje, udhëzime e rregullore të ndryshme.

Shteti fqinj Maqedonia, asgjësimin e mbeturinave farmaceutike e ka të rregulluar përmes “Rregullores për kushtet më të afërta (ngushta) për mënyrën e asgjësimit të mbeturinave farmaceutike”.

Sipas kësaj rregullore, barnat me afat të skaduar ndalohet të hidhen në kontejnerë për mbeturinat e zakonshme, nuk përzihen me barnat e tjera dhe nuk ruhen në ambiente të hapura.

Barnat me afat të skaduar pranohen nga ana e personave juridik të regjistruar për qarkullim me shumicë, importuesit, prodhuesit, barnatoret dhe të njëjtit i paraqesin për asgjësim më së voni deri në gjashtë muaj nga pranimi i tyre në Byronë për Barna.

Për pranim dorëzim hartohet procesverbal në dy kopje, nga një për secilën palë, cili ruhet deri në 3 vjet. Për aprovimin e asgjësimit të barnave në pajtueshmëri më ligjin kujdeset Byroja e Barnave e cila me së voni deri në 30 dite nga parashtrimi i kërkesës e jep aprovimin me shkrim për shkatërrim.

Me gjithë rregulloren në fuqi, edhe Maqedonia ballafaqohet me vështirësi të theksuar në administrimin me mbeturina farmaceutike.

Ndërsa në Serbi, Agjencia për Pajisje dhe Produkte Mjekësore menaxhimin e mbeturinave e ka filluar me organizimin e aktiviteteve të trajtimit, së pari mbeturinave të rrezikshme dhe sot i trajton në përgjithësi të gjitha llojet e mbeturinave.

Mbeturinat e rrezikshme të cilat nuk mund të trajtohen/ asgjësohen në këtë Agjenci eksportohen në vendet e Evropës që kanë insinerator adekuat.

Për tu eksportuar në një vend tjetër për asgjësim është e nevojshme të sigurohet një raport mbi karakteristikat e mbeturinave i cili është shumë detajuar dhe përfshin informatat si: numri kontrollit të mostrës, emri i produktit, numri serik, forma farmaceutike, përbërësi aktiv kimik/gjenerik (INN), datën e skadimit dhe sasinë(kg).

Bosnja dhe Hercegovina si vend i dalë nga lufta si edhe Kosova është ballafaquar me problemin e grumbullimit të mbeturinave farmaceutike.

Sipas OBSH-së është vlerësuar se rreth 800 tonë mbeturinë farmaceutike është grumbulluar si rezultat i ndihmave humanitare në BH. Një sasi e këtyre barnave të ardhura si ndihma humanitare kanë ardhur me afat të skaduar, ndërsa një sasi tjetër nuk është përdorur për shkak të arsyeve të ndryshme.

OBSH ka përgatitur një udhëzues për asgjësimin e barnave me afat të skaduar në BH, dhe gjithë procesin e ka ndarë në dy faza:

*Faza e parë- **Klasifikimi***: përfshin ndarjen e substancave të klasifikuara si të kontrolluara, toksike ose produkte të rrezikshme, dhe varësisht nga toksiciteti, forma farmaceutike (e ngurtë, lëngët, aerosole..) të zgjidhet edhe metoda e asgjësimit të tyre.

*Faza e dytë- **Metodat në Dispozicion për Asgjësim***: groposja, inserimi, kanalizimi, djegia në temperaturë të mesme, djegia në temperaturë të lartë, dhe metodat e tjera për llojet e veçanta farmaceutike.

Shpenzimet për asgjësimin e mbeturinave mjekësore-farmaceutike në BH janë mbuluar përmes fondeve të Bashkimit Evropian dhe shumica prej mbeturinave mjekësore-farmaceutike janë asgjësuar në Austri.

Kroacia përveç se e ka të rregulluar shumë mirë menaxhimin e mbeturinave mjekësore përmes ligjeve në fuqi që edhe aplikohen në realitet, investon shumë edhe në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve.

Përmes departamenteve të Mjedisit dhe Shëndetit, gjithashtu përmes Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik nga koha në kohë shpërndahen informata që kanë të bëjnë me edukimin shëndetësor dhe ndërmerren aktivitetet promovuese për menaxhimin e mbeturinave farmaceutike. Instrumentet që shfrytëzojnë për informim janë web-faqet me përmbajtje shëndetësore, broshurat si material edukativ, TV dhe radio, fletëpalosjet e ndryshme etj.

Gjithashtu një shembull tjetër të mirë, po nga **Kroacia** mund ta marrim iniciativën e kompanisë farmaceutike Pliva të Zagrebit, e cila me rastin e Ditës së Mjedisit me 5 qershor në bashkëpunim me Zyrën për Promovimin e Shëndetit për një muaj rresht ka organizuar mbledhjen e mbeturinave farmaceutike nëpër shtëpi. Mbledhja është bërë me anën e kontejnerëve të veçantë të Pliva-s. Qëllimi i kësaj initiative ishte që të vetëdijesohet popullata se çdo kontribut, pa marrë parasysh sa i vogël, sjell një hap më pranë një mjedisi të shëndetshëm.

Rekomandimet

1. Krijimi i një komisioni që do të merret me mbledhjen e informatave mbi sasinë e mbeturinave mjekësore/farmaceutike në Kosovë.
2. Krijimi i një grupi punues për klasifikimin e mbeturinave mjekësore/farmaceutike.
3. Analizimi i resurseve të Kosovës për ta përballuar asgjësimin. Cilat produkte/materiale mund të asgjësohen në Kosovë pa e ndotur mjedisin.
4. Bashkëpunim më i mirë ndër-ministror (MSh-MMPH-MB-MPB) me qëllim përpilimi të një projekti për asgjësimin e mbeturinave mjekësore/farmaceutike.
5. Ngritja e fondeve përfituese për asgjësimin e mbeturinave mjekësore/farmaceutike.
6. Konsultime me OBSH për ndihmën teknike dhe përvojat nga vendet tjera për zgjidhjen e këtij problemi.
7. Organizimi i fushatave informuese me qëllim sensibilizimin e qytetarëve për të ruajtur shëndetin dhe mjedisin.
8. Të merren masa për parandalimin e grumbullimit të mëtutjeshëm të mbeturinave mjekësore/farmaceutike.